

# TË BARABARTË


Thirrje Jo Racizmit



# PARA LIGJIT

# LINDI NË GREQI, FUNKSIONON EDHE NË KOSOVË

NDRINA (13), ELSA (13), ANILA (13), ALBINI (13), DIARTI (13), BLENDI (13)



*Të barabartë pa dallime!*

**Sot kemi folur për shumë gjëra të cilat janë të rëndësishme për ne qytetarët, për barazinë e të gjithë qytetarëve pa dallime**

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje. Hapat e parë të demokracisë u shfaqën në vitin 507 para erës sonë. Greqia është djepi ku mori hapat e parë demokracia. Ndryshe me demokraci kuptojmë të drejtat dhe liritë e përbashkëta të tërë popullit.

Demokracia ndahet në dy lloje: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë do të thotë se populli vendos në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Demokracia e drejtpërdrejtë ndodh në vendet me një numër më të vogël të qytetarëve ku ata marrin vendime për vendin e vet me anë të peticioneve dhe referendumeve.

Ndërsa, demokracia përfaqësuese është kur një grup i qytetarëve përfaqësohet nga një përfaqësues i vetëm, ose disa përfaqësues varësisht nga sistemi. Kemi dy sisteme të demokracisë përfaqësuese: sistemi parlamentar dhe sistemi presidencial.

Demokracia e sistemit parlamentar, është sistem i cili funksionon në Kosovë, ku deputetët zgjedhen nga ne qytetarët me anë të votës, me qëllim që të përmbushen interesat e qytetarëve.

Vota është e drejtë primare e çdo qytetari pa dallim feje, race, gjinie, e cila nuk detyrohet as nuk trashëg-

ohet nga askush.

Sistemi presidencial funksionon në Amerikë, ku presidenti zgjedhet nga votat e qytetarëve. Pra në demokraci, jemi të gjithë të barabartë pa asnjë dallim. Në jetën e përditshme problemi i parë që ne hasim, është diskriminimi dhe mohimi i të drejtës së shprehurit.

Në demokraci nuk lejohet diskriminimi por lejohet e drejta e të shprehurit. Pra me demokraci jemi të gjithë të barabartë pa marrë parasysh nivelin social, nivelin arsimor, gjininë apo moshën etj.

Mesazhi ynë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës është: ndal ngacmimin, ndal diskriminimin. Tani është koha të fillojmë një sjellje më të mirë për një jetë më të mirë!



Autorët e artikullit

# TI VENDOS PËR TË ARDHMEN TËNDE

ERA B. (13), ELSA (13), ERA G. (13), RINESA (13), REDONI (13)

## Në këtë artikull mund të lexoni për zgjedhjet në përgjithësi dhe zgjedhjet që mbahen në Republikën e Kosovës

Varfëria, shkeljet, paragjykimet dhe diskriminimi kanë qenë disa nga problemet kryesore në të gjithë botën. Ky problem tani është më i lehtë me anë të demokracisë.

Demokracia është trajtim i drejtë ndaj të gjithë njerëzve pa dallim moshe, gjinie, race, etnie, feje, etj. Prandaj, ne jemi të lirë ta shprehim mendimin tonë dhe të zgjedhim për vendin tonë, këtë e bëjmë me anë të zgjedhjeve që mbahen, ku populli vendos për përfaqësuesit e tyre me anë të votave.

Në Republikën e Kosovës të gjithë njerëzit mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të votojnë në procese zgjedhore, për shkak se atëherë jemi më të matur në vendimet që i marrim. Votimi luan rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë dhe të gjithë popullin.

Zgjedhjet ndahen në: zgjedhje komunale dhe zgjedhje qendrore.

Zgjedhjet komunale janë zgjedhjet ku populli voton dhe e zgjedh një përfaqësues për komunën e tij/saj, ku aty zgjedhet kryetari dhe asambleistët.

Zgjedhjet qendrore janë zgjedhjet ku populli voton dhe i zgjedh deputetët e shtetit që do të përfaqësojnë vendin e tyre.

Kuvendi është objekti ku qëndrojnë 120 deputetë dhe të gjithë ata janë të ndarë në disa parti.



Gazetarët e artikullit

Ata duhet të japin ide që të bindin popullin që t'i votojnë ata, në mënyrë që të kemi një shtet më të zhvilluar. Deputetët duhet të jenë punëtorë dhe t'i mbajnë premtimet që ia kanë dhënë popullit.

Edhe pse deputetët punojnë shumë nuk ka të ardhme më të zhvilluar pa bashkëpunimin e popullit ku ata duhet t'i respektojnë ligjet dhe ta bëjnë vendin më me rend. Ligjet pra janë rregulla të cilat duhet të respektohen nga të gjithë qytetarët.

Ne jemi të lirë, mirëpo nuk duhet ta keqpërdorim atë. Ne votojmë për më të mirën e vendit.

Bashkëpunimi mes popullit dhe deputetëve krijon një të ardhme të zhvilluar të vendit. Pra, demokracia qenka liria e të shprehurit të mendimit tonë siç u shprehëm ne sot duke diskutuar dhe punuar rreth artikullit tonë.



# NDARJA E PUSHTETIT NË KOSOVË

ARNISA (13), ANITA (14), ROLAND (13), OLTA (13), DION (13)

**Nga ne nxënësit e shollës „Emin Duraku“ do të mësoni se si bëhet ndarja e pushtetit në Republikën e Kosovës.**

Ndarja e pushtetit në Republikën e Kosovës bëhet në tri degë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor.

Në Pushtetin Legjislativ bën pjesë Kuvendi, i cili nxjerr dhe miraton ligjet. Në Kuvendin e Kosovës bëjnë pjesë gjithsej 120 deputetë që zgjedhen përmes votës së lirë të qytetarëve. Tri funksione kryesore të Kuvendit janë: përfaqëson popullin, mbikëqyr Qeverinë dhe miraton ligjet.


Të drejtë vote ka çdo njeri mbi moshën 18 vjeçare, sepse në këtë moshë jemi më të pjekur dhe e kuptojmë më mirë se si duhet të jetë deputeti që duhet ta votojmë. Prandaj, deputetët duhet që ta përfaqësojnë popullin në mënyrë sa më të mirë që është e mundur.



Bashkimi bën fuqi




Informacionet tona për ndarjen e pushtetit



Kuvendi i Republikës së Kosovës




Të gjithë duhet të jemi tolerant dhe të barabartë



Vota bën ndryshim


**Këtu do të mësoni për rolin e Pushtetit Ekzekutiv dhe Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Kosovës**




Në Pushtetin Ekzekutiv bën pjesë Qeveria e cila i zbaton ligjet e marra nga Kuvendi. Në Qeveri bëjnë pjesë: Kryeministri, ministrat dhe zëvendësministrat. Edhe Qeveria ka të drejtën e paraqitjes së projektligjeve në Kuvend.

Roli i secilit pushtet është që ta kryej detyrën e vet sa më mirë, prandaj për funksionim të shtetit edhe qeveria duhet t'i kryej detyrat e saj.

Pushteti gjyqësor përbëhet nga gjykatat. Gjykatat kanë për detyrë të vendosin drejtësi, rregull dhe qetësi në vend. Gjykata ka rol themelor në demokracinë e një shteti dhe në vendimet e saj nuk ka dallime dhe trajtohen të gjithë të barabartë. Gjykatat ndahen në tri lloje: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Pra ndarja e pushtetit bëhet në mënyrë që punët e një shteti të funksionojnë sa më mirë dhe secili pushtet ta kryej punën e tij në mënyrë të pavarur.



Të gjithë mund ta ndërtojmë demokracinë



Gjykata vendos drejtësi



Të gjithë jemi të barabartë



E ardhmja e vendit

# NE JEMI QYTETARË

JETA (13), EDONIS (13), VJOSA (13), RINESA (13), DIONA (14)

## Të barabartë për një qytet dhe një shtet më të mirë


Qytetar konsiderohet çdo person i cili ka leje banimi në një shtet të caktuar. Që të jetë pjesë e atij vendi, personi merr përsipër përgjegjësi të ndryshme ku posedon të drejta në favor të qytetarit. Të drejtat tona si qytetarë janë të mbrojtura me ligj. Të drejtat tona janë: të zgjedhim, të votojmë, të shprehemi lirshëm derisa shprehja mos ta ofendojë tjetrin, të punojmë etj. Po ashtu ne si qytetarë kemi përgjegjësi. Pra, ne kemi përgjegjësi të respektojmë ligjin, të paguajmë taksat për shërbimet të cilat i ofron shteti, të mbajmë ambientin e pastër, të respektojmë njëri-tjetrin, të mos diskriminojmë, etj. Çdo qytetar duhet të jetë aktiv. Disa mënyra se si të jemi aktiv janë: të dalim në protesta paqësore për përmirësimin e gjendjes politike, sociale kulturore apo ekonomike.



Autorët e artikullit




Në demokraci të gjithë jemi të barabartë, pa dallim race, besimi apo kombi



Të drejtat dhe përgjegjësitë tona



Përgjegjësi e jona është ta mbajmë ambientin e pastër




### Ne si fëmijë kemi të drejta. Mësojeni duke e lexuar artikullin tonë, se kush na i mbron të drejtat tona

Për shumë vite, të drejtat tona si fëmijë nuk janë respektuar sa duhet. Ka pasur raste kur fëmijët janë detyruar të bëjnë punë të rënda fizike të cilat kanë ndikuar në jetët e tyre. Duke marrë parasysh rrethanat, organet ligjore kanë krijuar një dokument të quajtur Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e cila vlen për personat nën moshën 18 vjeçare. Ky dokument u miratua më 30 nëntor 1990. Në bazë të këtij dokumenti jeta e fëmijëve u përmirësua.

Kjo Konventë thekson se çdo fëmijë ka të drejtën e jetës, të kujdesit familjar, të shtetësisë, të edukimit dhe vijimit të shkollës, marrjes pjesë në aktivitete edukative, të drejtën e lojës, etj. Pa marrë parasysh

këtë dokument, në shumë vende të botës këto të drejta shkelen. Fëmijët diskriminohen në bazë të fesë, racës apo ngjyrës, prejardhjes, etj. Shumica e fëmijëve në botë, kryesisht në Afrikë, nuk kanë kushte themelore për të zhvilluar një jetë normale.

Ata përballen me mungesë të lëndëve primare për jetë, si ujë i pastër, ushqim, dhe vendstrehim. Për parandalimin e këtyre kushteve jo të mira veprojnë organizata të ndryshme si Save the Children, UNICEF, etj. Ne duam që të drejtat tona të respektohen që të kemi një të ardhme më të mirë dhe të sigurtë, si për ne ashtu edhe për vendin. Mos harroni se ne jemi e ardhmja e vendit.





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Emin Duraku“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-3  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë